

VENDIM
Nr. 127, datë 16.1.2026

**AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE “FONDI NË MBËSHTETJE TË
NDËRMARRJES SOCIALE PËR PERIU DHËN 2026–2028”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen, e:

- znj. Delina Ibrahimaj kryetare;
- znj. Mimoza Dhëmbi; anëtare;
- z. Besnik Çina anëtar;
- znj. Keida Qirko; anëtare;
- z. Ahmet Mançellari; anëtar,

në mbledhjen e tij të radhës, të datës 16.1.2026, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, mori në shqyrtim njoftimin e skemës së ndihmës shtetërore të njoftuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për mbështetjen e ndërmarrjes sociale nëpërmjet “Fondit në mbështetje të ndërmarrjes sociale për periudhën 2026–2028”.

I. Procedura

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS), me shkresën nr. 4575 prot., datë 21.11.2025, me lëndë “Dërgohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi ‘Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2026–2028’”, ka njoftuar skemën e ndihmës shtetërore “Fondi në mbështetje të ndërmarrjes sociale”. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, me shkresën 1947/1, datë 5.12.2025, në bazë të nenit 5, të VKM-së nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’” kërkoi nga MSHMS-ja plotësimin e formularit të njoftimit. MSHMS-ja, me shkresën nr. 4575/2, datë 29.12.2025, “Dërgohet formulari bazë për njoftimin e ndihmave shtetërore lidhur me projektvendimin e Këshillit të Ministrave ‘Për format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit të ndërmarrjeve sociale për periudhën 2026–2028’”. Në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e ndihmës shtetërore, në bazë të planit të ndihmës shtetërore të sipërpërmendur.

II. Përshkrimi i masës

2. *Qëllimi*: Mbështetja me grante nga buxheti i shtetit nëpërmjet “Fondi në mbështetje të ndërmarrjes sociale” për ndërmarrjet sociale që kontribuojnë në mbrojtjen shoqërore dhe mbështetjen e grupeve të pafavorizuara, nëpërmjet punësimit të tyre dhe ofrimit të shërbimeve për to.

3. *Baza ligjore e planit të ndihmës*: Plani i ndihmës shtetërore mbështetet në nenin 26, të ligjit nr. 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcakton se ndërmarrjet sociale mbështeten nga shteti nëpërmjet subvencionimit të tyre ose të punonjësve në këto subjekte, format e të cilit rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, pas vlerësimit të bërë nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore. Referuar njoftimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS), është parashikuar mbështetje buxhetore sipas projektvendimit të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2026–2028”, në zbatim të detyrimeve ligjore për promovimin e masave financiare për këto subjekte.

4. *Kohëzgjatja*: Skema e ndihmës do të zbatohet në periudhën 2026–2028.

5. *Dhënësi i ndihmës dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës*: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

6. *Përfituesit*: Përfitues janë ndërmarrjet sociale, në kuptim të ligjit nr. 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”.

7. *Shtrirja sektoriale dhe territoriale*: Projekti do të zbatohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

8. *Forma dhe vlera e ndihmës*: Buxheti i skemës në formën e grantit është 210,000,000 lekë, për periudhën 2026–2028. Në projektvendimin e Këshillit të Ministrave të referuar në formularin e njoftimit është parashikuar se një ndërmarrje sociale do të financohet nëpërmjet: 1. subvencionimit të pagës minimale; dhe 2. i sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

9. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore përbën ndihmë shtetërore, në kuptim të nenit 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

10. Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcakton, se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara, ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore.”.

11. Gjithashtu, neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane, të shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë,¹ përcakton, se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87, të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”.

12. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) për zgjedhja; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

13. Plan i ndihmës do të financohet nga buxheti i shtetit i miratuar për MSHMS-në. Në zbatim të nenit 26, të ligjit nr. 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni vlerëson se subvencionimi i ndërmarrjeve/i punonjësve nga grupet e pafavorizuara në këto subjekte përbën një masë mbështetëse që synon mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël. Ky subvencionim akordohet nga burimet shtetërore dhe u jep një avantazh ekonomik ndërmarrjeve që mbajnë statusin “Ndërmarrje sociale” në raport me operatorët e tjerë në treg, pasi këto subjekte ushtrojnë veprimtari ekonomike në prodhim mallrash apo ofrim shërbimesh. Megjithatë këto subjekte kanë qëllim social, Komisioni vlerëson se plani nuk cenon funksionimin e rregullt të tregut të brendshëm dhe nuk shkakton shtrembërim të konkurrencës me ndërmarrjet e krijuara në treg apo me vendndodhjen e faktorëve të prodhimit.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se, në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, plani i ndihmës është ndihmë shtetërore, e cila është e ndaluar përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

¹ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e ‘Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare’”.

14. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, i cili parashikon:

“Ndhma “De minimis” është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.”.

Mbështetur në kreun II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës ‘De minimis’”, vlera maksimale e lejuar e ndihmës, si dhe kushtet për autorizimin e ndihmës përcaktohet si vijon:

1. Ndhma lejohet nëse përmbushen, njëherësh, të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi;

b) ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi.

Në kreun III, “Llogaritja e ekuivalentit bruto të grantit”, të VKM-së nr. 605, datë 31.8.2016, përcaktohet se: “1. Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente”.

Sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe VKM-në nr. 605/2016, ndihma “De minimis” lejohet, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi;

b) ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi.

Dhënësi i ndihmës do të akordojë dhënien e ndihmës shtetërore në formën e grantit nga buxheti i shtetit për ndërmarrjet sociale në një shumë, e cila nuk kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore “De minimis” është i lejueshëm në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 8, 22, dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar:

VENDOSI:

1. Të autorizojë planin e ndihmës shtetërore në formën e grantit “Fondi në mbështetje të ndërmarrjes sociale 2026–2028”, të propozuar nëpërmjet projektvendimit të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2026–2028”, në zbatim të detyrimeve të nenit 26, të ligjit nr. 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”.

2. Çdo përfitues i ndihmës duhet të nënshkruaj deklaratën e ndihmës “De-minimis” dhe të dorëzoj një kopje të deklaratës pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Vlera totale e ndihmës së dhënë një ndërmarrjeje nuk duhet të kalojë 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe impaktin ekonomik të skemës.

4. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE

Kryetar: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Mimoza Dhëmbi, Besnik Çina, Keida Qirko, Ahmet Mançellari